



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1017/6Prot.

Tiranë, më 15.11. 2023

V E N D I M

Nr. 234 , datë 15.11. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 175, datë 21.09.2023, të paraqitur nga z. P. F, kundër Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për shkak të bindjeve politike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi shpjegon se, është punësuar pranë Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, në pozicionin “Inspektor taks force” në datën 15.03.2023 me një kontratë 3 mujore fillimisht, e cila i është rinovuar dhe njëherë për 3 muaj të tjerë. Ankuesi ka menduar se kontrata e dytë është për një periudhë 6 mujore sipas ligjit, gjë të cilën nuk e ka vënë re në momentin e lidhjes së saj. Me mbarimin e kontratës së dytë në datën 15 shtator është thirrur dhe është njoftuar verbalisht për largimin nga puna.

Ankuesi shprehet se, përveç faktit të mos zbatimit të rregullave të parashikuara në Kodin e Punës, lidhur me afatet e njoftimit të largimit nga detyra, apo paralajmërimeve, pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve të tija politike, pasi me ndryshimin e kryetarit të ri të Bashkisë Shkodër kanë ardhur dhe lëvizjet në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a. Ankuesi është i bindur që largimi i tij nga detyra ka qenë vetëm fakti i bindjeve të tija politike, gjë e cila duket qartë pasi nuk ka patur asnjë vëretje apo tërheqje vëmendje lidhur me realizimin e detyrës së tij si inspektor.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga institucioni i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për shkak të bindjeve politike dhe rikthimin në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 175, datë 21.09.2032, të bërë nga z.P. F, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1017/1 prot., datë 25.09.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për ankesën e bërë nga z.P. F si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Infomacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e z. P. F.
 - Kopje të librezës së punës dhe kontratës/kontratave të punës të lidhura me ankuesin.
 - Kopje e plotë të dosjes personale të ankuesit.

- Kopje të urdhërit të lirimit nga detyra të ankuesit, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues dhe procedurën e ndjekur (njoftime, procesverbale, urdhra, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës dhe lirit të tij, si dhe çdo akt ose informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje)
- Kopje të strukturës së administratës së Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për vitin 2023 dhe asaj të mëparshme.
- A është plotësuar pozicioni i punës i mbajtur nga ankuesi me punonjës tjetër? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion kopje të praktikës së emërimit të punonjësit të ri si dhe dosjen personale të punonjësit.
- Informacion nëse ka punonjës të tjerë, të cilëve i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe a ka ndryshuar administratori i shoqërisë me ardhjen e kryetarit të ri të bashkisë.
- Informacion nëse urdhëri i lirit nga detyra është ankimuar në gjykatë, nëse po të na vihet në dispozicion kopje e kërkesë padisë.
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështje.

Me shkresën nr. 657/1 prot., datë 07.10.2023 Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, ka dërguar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e sipërcituar.

Me shkresën nr.1017/3 prot., datë 17.10.2023 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, drejtuar z. P. F, i është përcjellë shkresa nr. 657/1 prot., datë 07.10.2023 e Shoqërisë Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për të bërë parashtrimet e tija, por që nga ankuesi nuk u kthye përgjigje.

Me shkresën nr. 1017/4 prot., datë 30.10.2023 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 15.11.2023, ora 11:00.

Me shkresën nr.1258 prot., datë 13.11.2023, është administruar kërkesa e z. P. F, me objekt: *Heqim dorë nga kërkesa me palë kërkuese Pavlin Fusha kundrejt palës tjetër Bashkisë Shkodër (Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a), duke sqaruar se: Duke qenë se marrëdhëniet e kërkuesit me palën tjetër të paditur janë rregulluar kërkojmë heqjen dorë nga ankesa që kemi bërë kundrejt tyre. Ankuesi nuk ka më interes për vazhdimin e kësaj çështje dhe për pasojë heq dorë nga ankesa. Në këto kushte, kërkojmë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për arsye të heqjes dorë të vendosë mospranimin e ankesës dhe që shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës të mos vazhdojë.*

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pikat 1 dhe 3, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e pales.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe bazuar në kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi me nr.1258 prot., në datën 13.11.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 175, datë 21.09.2023, të paraqitur nga z. P. F, kundër Shoqërisë Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për shkak të bindjeve politike, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 175, datë 21.09.2023, të paraqitur nga z. P F, kundër Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për shkak të bindjeve politike, për arsye se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA